



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2025

Lënda: HISTORI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Masa e gjerë e popullsisë në Greqinë antike quhej: **1 pikë**
A) qytetarë të lirë.
B) skllevër.
C) demos.
D) polis.
2. Porti kryesor në brigjet perëndimore të Adriatikut që njihet si "Metropoli i Ilirikut" gjatë periudhës Bizantine ishte: **1 pikë**
A) Bylisi.
B) Lisus.
C) Durrësi.
D) Shkodra.
3. Shtresa më e lartë shoqërore në Perandorinë Romake ishin: **1 pikë**
A) patricët.
B) plebejtë.
C) klientët.
D) triaret.
4. Çfarë ishte ostrakizmi? **1 pikë**
A) Një formë qeverisjeje e bazuar në kritere pronësie.
B) Një fe mistike në Greqinë e lashtë, me qendër në Delphi.
C) Praktika midis atyre që kanë fuqi për të favorizuar të afërmit ose miqtë.
D) Dëbimi nga Athina përmes votës së qytetarëve i kujtdo që ishte i padëshiruar.
5. "Në gjysmën e parë të shek. XIV popullsia e qyteteve u rrit mjaft. Qyteti u bë një qendër që thithte vazhdimisht banorë të rinj nga zonat fshatare. Durrësi dhe Shkodra në shek. XIV njohën një dyndje të madhe banorësh të rinj të ardhur nga fshatrat përreth. Në mjaft raste autoritetet e mirëprisnin këtë imigracion të brendshëm".
"Historia e popullit shqiptar", Vëllimi I
Qytetet mesjetare arbërore drejtoheshin nga: **1 pikë**
A) Mbreti.
B) Perandori.
C) Parlamenti.
D) Këshilli i fisnikëve.
6. Konflikti midis Balshajve dhe Topiajve ndodhi për shkak të qytetit të: **1 pikë**
A) Shkodrës.
B) Durrësit.
C) Ulqinit.
D) Artës.
7. Influenca e Xhon Lokut në Revolucionin Francez gjen shprehje në kundërshtinë e tij ndaj: **1 pikë**
A) partive politike.
B) reformave sociale.
C) monarkive absolute.
D) fuqisë së parlamentarizmit.

8. Sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, cili nga shtetet e mëposhtme **NUK** përfitonte nga territoret shqiptare që do të copëtoheshin? **1 pikë**
- A) Serbia.
B) Greqia.
C) Mali i Zi.
D) Bullgaria.
9. Cili nga revolucionet e zhvilluara në Angli shënoi triumfin e parlamentit ndaj monarkisë? **1 pikë**
- A) Revolucioni Agrar.
B) Revolucioni i Tetorit.
C) Revolucioni Industrial.
D) Revolucioni i Lavdishëm.
10. Një nga qëllimet kryesore të reformave në Rusi nën Pjetrin e Madh (1689-1725) ishte që statusi i lartë shoqëror të varej më shumë nga: **1 pikë**
- A) anëtarësimi në kishën ortodokse.
B) prejardhja aristokratike.
C) shërbimi ndaj shtetit.
D) niveli i pasurisë.
11. "Rrethimi mbi katërmujor i Krujës nga turqit, të udhëhequr nga vetë Sulltan Murati II që një dështim i plotë. Skënderbeu i cili në kështjellën e tij kryesore kishte lënë vetëm një garnizon të vogël dhe me pjesën më të madhe të ushtrisë së tij vepronte nga malet përreth, mundi të kthehej përsëri në Krujë nga fundi i tetorit 1450. Ky sukses shkaktoi habi të madhe në gjithë Evropën e krishterë. Papa Nikolla V, mbreti Ladislav V i Hungarisë dhe mbreti Alfons I i Napolit dërguan urimet e tyre dhe ofruan ndihmë".
- Peter Bartl "Shqiptarët"
- Traktati i Gaetës i vitit 1451 u nënshkrua mes Skënderbeut dhe: **1 pikë**
- A) Republikës së Venedikut.
B) Mbretërisë së Hungarisë.
C) Mbretërisë së Napolit.
D) Shtetit të Papës.
12. Konflikt i hapur midis 13 kolonive Amerikës së Veriut dhe Britanisë së Madhe u quajt. **1 pikë**
- A) Revolucioni i Lavdishëm.
B) Revolucioni Amerikan.
C) Lufta për Pavarësi.
D) Lufta Civile.
13. Në kudrat jepen disa nga ngjarjet që lidhen me një nga luftërat e mëposhtme. Me cilën nga luftërat lidhen këto tre ngjarje? **1 pikë**
- A) Lufta franko – prusiane.
B) Lufta e Krimesë.
C) Lufta I Botërore.
D) Lufta e Ftohtë.
1. *Arqiduka Franz Ferdinand u vra.*
 2. *Gjermania i shpall luftë Ruisë dhe Francës.*
 3. *Beteja e Verdunit.*
14. Shtetet që mbështetën çështjen shqiptare gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912), ishin: **1 pikë**
- A) Austro - Hungaria dhe Gjermania.
B) Italia dhe Britania e Madhe.
C) Austro - Hungaria dhe Italia.
D) Gjermania dhe Franca.

15. Ndryshimi midis dy sistemeve totalitare të majta e të djathta u vu re në drejtim të: 1 pikë
- A) indoktrinimit të njerëzve.
 B) rrjetit të informacionit.
 C) përdorimit të terrorit.
 D) sistemit ekonomik.

16. Cilën nga masat e mëposhtme mori kryeministrja Margaret Theçer? 1 pikë
- A) Nxitjen e rolit të sindikatave në jetën ekonomiko-shoqërore.
 B) Shtimin e subvencioneve shtetërore për kompanitë publike.
 C) Politikën ekonomike dhe financiare anti – inflacioniste.
 D) Rritjen e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

17. Në hartë tregohen zonat e kontrollit të katër aleatëve të mëdhenj të Luftës së Dytë Botërore. Cilat janë dy shtetet që u krijuan prej tyre? 1 pikë
- A) Polonia dhe Gjermania.
 B) Bosnja dhe Hercegovina.
 C) Pakistani Lindor dhe Pakistani Perëndimor.
 D) Gjermania Lindore dhe Gjermania Perëndimore.



18. Këshilli Kombëtar i dalë nga Kongresi i Lushnjës luante rolin e: 1 pikë
- A) kryetarit të qeverisë.
 B) kryetarit të shtetit.
 C) parlamentit.
 D) pleqësisë.

19. Kushtetuta e vitit 1976 përcaktonte si formë të pronësisë në Shqipëri atë: 1 pikë
- A) zejtare dhe tregtare.
 B) tregtare dhe artizanale.
 C) shtetërore dhe kolektive.
 D) artizanale dhe shtetërore.

20. Më poshtë jepen disa parime të një prej organizatave të rëndësishme ndërkombëtare.
- I jepet fund përdorimit të forcës ushtarake me përjashtim të rasteve për vetëmbrojtje kombëtare.
 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe atyre të shteteve duhet të bëhet me mjete paqësore.
 - Të bashkëpunohet për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve.
 - Të njihet dhe respektohet sovraniteti kombëtar dhe e drejta e kombeve për vetëvendosje.

- Parimet e mësipërme janë kusht për çdo vend që anëtarësohet në: 1 pikë
- A) OKB
 B) NATO
 C) OSCE
 D) UNDP

21. Pirro i Epirit u shqua si një drejtues vizionar në fushën politike, ushtarake dhe atë ekonomike. Jepni nga një argument që tregon aftësitë e Pirros në secilën nga fushat. **3 pikë**

Në fushën politike: _____

Në fushën ushtarake: _____

Në fushën ekonomike: _____

22. Për t'ju përgjigjur pyetjes bazohuni në dokumentin e mëposhtëm.

"Historianët pajtohen se rënia e ekonomisë monetare në Perandorinë Romake të vonë solli krijimin e sistemit të çifligut (bazuar në bujkrobërinë) dhe se ringjallja e një ekonomie monetare shkaktoi rënien e këtij sistemi. . . Nën sistemin e çifligut një aristokrat kontrollonte pjesën më të madhe të tokës së bashku me privilegjet ekonomike, politike dhe ligjore që vinin me një autoritet të tillë. Masa e banorëve të mesjetës së hershme të Evropës ishin fshatarë jo të lirë, të lidhur fort me tokën dhe me vullnetin e zotërisë së tyre. Ndonëse studiuesit e çifligut kanë qenë prej kohësh të kujdesshëm për të bërë një dallim midis sistemit të çifligut dhe feudalizmit, të dyja këto sisteme shpesh ngatërrohen dhe bashkohen nën termin feudalizëm. Feudalizmi ishte sistemi politik dhe ushtarak që hyri në praktikë rreth katër shekuj pas sistemit të çifligut dhe që ishte mbivendosur (shtuar) mbi të. Të gjithë njerëzit e përfshirë në feudalizëm ishin të lirë dhe në përgjithësi ishin aristokratë të lidhur me njëri-tjetrin nga të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella. Kalorësi feudal ndoqi profesionin e nderuar të luftimit; fshatari ndoqi profesionin e "panderuar" të punimit të tokës në mënyrë që zotëria e tij të mund të hante."

Bryce Lyon, Mesjeta në mendimin e fundit historik, 8

Bazuar në dokumentin e dhënë dhe në njohuritë tuaja, evidentoni tri tipare të çifligut.

3 pikë

23. Përhapja e fesë islame në tokat shqiptare ishte një dukuri e shkaktuar prej bashkëveprimit të një numri faktorësh të natyrave të ndryshme: politike, ekonomike, kulturore dhe fetare. Procesi i islamizimit kaloi në rrugë të ndryshme në varësi të politikave osmane dhe faktorëve lokalë.

Identifikoni tre nga format që u përdorën për islamizimin e popullsisë shqiptare.

3 pikë

24. Shpjegoni tri nga arsyet që çuan në fillimin e Revolucionit Francez.

3 pikë

25. Për t'ju përgjigjur pyetjes, referojuni burimeve të mëposhtme.

Burimi 1

Duke kaluar te manufakturat, gjejmë këtu faktin e gjithanshëm se krijimi i fabrikës që zëvendësoi artizanatin ishte pasojë e zbulimeve mekanike të kohës. Katër shpikje të mëdha ndryshuan karakterin e prodhimit të pambukut; makina tjerrese (jenny), me patentë nga Hargreaves në 1770; "korniza e ujit" (përdorimi i ujit si forcë lëvizëse), e shpikur nga Arkwright një vit më parë; makina tjerrese e Crompton u prezantua në 1779 dhe makina vetëvepruese e shpikur për herë të parë nga Kelly në 1792, por nuk u përdor derisa Roberts e përmirësoi atë në 1825. Asnjë nga këto në vetvete nuk do të kishte revolucionarizuar industrinë. Por në vitin 1769 - viti në të cilin lindën Napoleoni dhe Uellingtoni - James Watt nxori patentën e tij për motorin me avull. Gjashtëmbëdhjetë vjet më vonë u aplikua në prodhimin e pambukut. Në 1785 Boulton dhe Watt bënë një motor për një mulli pambuku në Pappleuick në Notts, dhe në të njëjtin vit patenta e Arkwright skadoi. Këto dy fakte të marra së bashku shënojnë futjen e sistemit të fabrikës. Por shpikja më e famshme nga të gjitha dhe më e madhe për industrinë vendase, tezgjahut, u krijua nga Cartwright në 1785.

Burimi: Arnold Toynbee, Leksione mbi Revolucionin Industrial, shek. 18-të në Angli, Humboldt (përshtatur)

Burimi 2

"... Çdo qytet i madh ka një ose më shumë zona të varfra të cilat janë të mbushura me klasën punëtore. Ndonjëherë, sigurisht, varfëria gjendet e fshehur në rrugicat afër shtëpive madhështore të të pasurve... Ato janë përgjithësisht shkretëtira të paplanifikuara të shtëpive me tarracë një ose dykatëshe të ndërtuara me tulla. Kudo që është e mundur këto kanë bodrume të cilat përdoren edhe si banesa. Këto shtëpi të vogla me tre ose katër dhoma dhe një kuzhinë, quhen cottages. Në të gjithë Anglinë, me përjashtim të disa pjesëve të Londrës, janë ato ku zakonisht jeton klasa punëtore. Vetë rrugët zakonisht janë të paasfaltuara dhe plot gropa. Ato janë të pista dhe të mbushura me mbeturina kafshësh dhe perimesh. Meqenëse nuk kanë as ulluqe dhe as kullues, mbeturinat grumbullohen në pellgje të ndenjura e të qelbura. Ventilimi në lagjet e varfra është i pamjaftueshëm për shkak të natyrës së paplanifikuar të këtyre zonave. Shumë njerëz jetojnë të grumbulluar së bashku në një zonë shumë të vogël, dhe kështu është e lehtë të imagjinohet natyra e ajrit në këto lagje punëtorësh. . . ."

Burimi: Friedrich Engels, The Condition of the Working Class in Angli, W. O. Henderson dhe W.H. Chaloner, Stanford University Press

Bazuar në dokumentet e mësipërme dhe në njohuritë tuaja, nxirrni dy aspekte pozitive dhe një aspekt negativ të Revolucionit Industrial.

3 pikë

Dy aspekte pozitive:

Një aspekt negativ:

26. Procesi i projektimit të së ardhmes pas Luftës së Dytë Botërore u kristalizua në vendimet e disa konferencave që bënë aleatët (BS, Anglia dhe ShBA). Një ndër konferencat që mori vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e sistemit botëror ishte ajo e Jaltës.

Rendi tri vendimet kryesore që u morën në Konferencën e Jaltës.

3 pikë

27. Jepni tre nga nenet kryesore të Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë (1925).

3 pikë

28. Pas çlirimit Shqipëria u përball me problemet e një ekonomie të shkatërruar, infrastrukturë të dëmtuar rëndë dhe shumë uzina e fabrika jashtë funksionit.

Cilët ishin tri faktorët që ndikuan në rimëkëmbjen e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore?

3 pikë

29. Cilat ishin tri nga arsyet e zhvillimit ekonomik në shtetet e bllokut perëndimor pas Luftës II Botërore?

3 pikë

30. Shpjegoni tre vendimet e Traktatit të Fshehtë të Londrës në lidhje me Shqipërinë.

3 pikë

31. Lindja dhe përhapja e fashizmit në Itali lidhet me disa faktorë të aspektit politik, ekonomik dhe shoqëror. Jepni nga një faktor që ndikoi në lindjen e fashizmit në Itali për secilin nga aspektet.

3 pikë

Politik:

Ekonomik:

Shoqëror:

32. "Ahmet Zogu qe kthyer në pushtet me ndihmën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, kryesisht sepse ajo shpresonte të kënaqeshin pretendimet e saj territoriale. A. Zogu ishte i vendosur t'i jepte fund vështirësive ekonomike, që cikloheshin në mënyrë të pandërprerë. Në këto rrethana, kursi i tij ishte të kthehej nga Italia dhe njëkohësisht ta zbuste Jugosllavinë duke i njohur pretendimet e saj".

Joseph Swire, "Ngritja e një Mbretërie"

a) Identifikoni ndryshimin territorial që ndodhi mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene me rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut. 1 pikë

b) Shpjegoni dy nga arsyet pse marrëdhëniet mes këtyre dy vendeve nuk patën jetëgjatësi. 2 pikë

33. Për t'ju përgjigjur pyetjes, referojuni burimeve të mëposhtme.

Burimi 1

"Miq dhe shokë, për shkak se Mikhail Gorbaçov nuk është në gjendje, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, të kryejë detyrat e Presidentit të BRSS, zëvendës presidenti ka marrë përkohësisht detyrën e Presidentit.

Ne ju drejtohemi sot në një moment që është vendimtar për fatet e Bashkimit Sovjetik dhe situatën ndërkombëtare në mbarë botën. Pasi ka hyrë në rrugën e reformave të thella dhe duke bërë një rrugë të konsiderueshme në këtë drejtim, Bashkimi Sovjetik ka arritur tashmë në një pikë ku ndodhet përballë një krize të thellë. Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj krize kërcënon rrjedhën e reformave tona dhe mund të sjellë pasoja të rënda në jetën ndërkombëtare.

Në shumë rajone të BRSS, si pasojë e përleshjeve ndëretnike, po derdhet gjak. Rënia e BRSS do të kishte pasojat më të rënda jo vetëm brenda por edhe ndërkombëtarisht. Në kushte të tilla nuk kemi alternativë, veçse të ndërmarrim hapa vendimtarë për të ndaluar rrëshqitjen e vendit në katastrofë."

Nga një konferencë shtypi e dhënë nga Komiteti Shtetëror për Gjendjen e Jashtëzakonshme, që vepron si udhëheqja e re sovjetike, 19 gusht 1991. Kjo pasoi largimin e Gorbaçovit nga detyra.

Burimi 2

Bush: Thjesht desha të dija se si po shkojnë gjërat nga ana juaj.

Jelcin: Një grup prej tetë individësh ka bërë një grusht shteti antikushtetues. Zëvendës presidenti Yanayev po përdor pretekstin se Gorbaçovi është i sëmurë, por kjo nuk konfirmohet. Trupat ushtarake janë sjellë në Moskë. Unë dola para popullit dhe ushtarëve dhe thashë se veprimet e Komitetit Shtetëror ishin antikushtetuese, të paligjshme dhe nuk kanë fuqi në territorin rus. Ndërtesa e Sovjetit Suprem dhe zyra e Presidentit janë të rrethuara dhe pres në çdo moment goditjen e godinës. Unë u kam bërë thirrje 100 000 njerëzve që qëndrojnë jashtë për të mbrojtur qeverinë e zgjedhur ligjërish. Në thelb ky është një grusht shteti i krahut të djathtë.

Zoti President, do të ishte mirë nëse ju vetë të mund të kërkonti të flisnit në telefon me Z. Gorbaçov dhe të mbledhni liderët botërorë për faktin se situata këtu është kritike.

Bush: Ju keni mbështetjen tonë të plotë për kthimin e Gorbaçovit dhe qeverisë legjitime.

Nga një telefonatë private midis Presidentit të Shteteve të Bashkuara, George Bush dhe Presidentit të Republikës së Rusisë, Boris Yeltsin, 20 gusht 1991.

Burimi 3

"Bashkatdhetarë,

Po jap dorëheqjen për arsye parimore. Politika e copëtimit të këtij vendi dhe e përçarjes së shtetit është diçka me të cilën nuk mund të pajtohem. Kjo është mundësia ime e fundit t'ju drejtohem, dëshiroj t'ju informoj për atë që mendoj për rrugën që kemi marrë që nga viti 1985. Procesi i rinovimit të këtij vendi dhe sjellja e ndryshimeve drastike në komunitetin ndërkombëtar është dëshmuar të jetë shumë më i ndërlikuar nga sa mund ta imagjinonte kushdo. Megjithatë, ne tani po jetojmë në një botë të re. Ne kemi dhënë një shembull për ristrukturimin e një vendi mbi një bazë paqësore demokratike.

I gjithë ky ndryshim krijoi shumë tendosje dhe u rezistua nga forcat reaksionare, si nga strukturat partiake dhe shtetërore, ashtu edhe nga elita ekonomike. Sistemi i vjetër u shpërbë edhe përpara se sistemi i ri të fillonte të funksiononte. Unë jam i shqetësuar që njerëzit në këtë vend po pushojnë së qeni qytetarë të një fuqie të madhe dhe pasojat mund të jenë shumë të vështira për t'u përballur për të gjithë ne."

Nga fjalimi i Gorbaçovit drejtuar kombit për dorëheqjen e tij si Sekretar i Përgjithshëm i CPSU dhe President i BRSS, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, 25 dhjetor 1991.

Duke iu referuar burimeve, vlerësoni katër arsye të dështimit të reformave të ndërmarra nga M. Gorbaçov, që çuan në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. **4 pikë**
